

INTERVISTË ME LINDA GUSIAN

Prishtinë | Data: 13 dhjetor, 2024

Kohëzgjatja: 101 minuta

Të pranishëm:

- Linda Gusia (e Intervistuar)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Adea Batusha (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Linda Gusia: M'ka ra n'mend n'90-tat shkojshim në Dodonë edhe e kqyrshim 'Profesor jom talent se jo mahi', edhe mram m'ra n'mend kshtu kesha vet me veti se nuk di çka me thanë për fmiminë teme. E m'ra n'mend. Tashti gjyna që s'kom sens t'mirë t'humorit me përformu ktu diçka për fmininë teme se kjo, 'Profesor jom talent se jo mahi' u kanë kshtu si nifar' përformance ku aktorët të cilët dilshin n'skenë edhe tregojshin për vetën. A din, "Unë vi kshtu... unë vi prej ni familje të varfur por bujare", a din (qeshë).

Edhe kur, a din, kshtu kur ki me histori orale duhesh me folë për vetin edhe thashë, "Okej si ajo 'Profesor jom talent se jo mahi', m'u nalë edhe me përformu jetën teme (qeshë). Kshtuqë yeah... jo n'rregull osht' (qeshë). Se e bojmë.

Anita Susuri: Osht' interesant se qajo shfaqja thojnë se kanë ardhë studentat e profesorit kishe me u tregu a çka ka qenë diçka?

Linda Gusia: Jo, Dodona ka qenë prej atyne pak hapësirave në Prishtinë...

Anita Susuri: Qajo skenë, audicionet.

Linda Gusia: Audicionet, po, ka qenë edhe në Bosnje ka qenë *bosanska audicija* edhe ka qenë pikërisht qishtu domethanë. Kanë ardhë edhe osht' dita e parë kur aktorët vijnë me u regjistru, ashtu në, në shkollë, në fakultet edhe duhet me tregu për vetën e vet edhe me përformu edhe me zgjedhë ni vepër. E 'Profesor jom talent se jo mahi', ka qenë kshtu shfaqja kshtu ma e popullarizune në Prishtinë, ku jemi shku shumë edhe kemi qeshë shumë.

Shumë ma vonë kur kom marrë me analizu Dodonën si hapësirë të rezistencës e kom pa gjenialitetin e Faruk Begollit në mënyrën se qysh e ka përdorë komedinë edhe humorin si formë të rezistencës. Derisa unë kom qenë shumë e re na kemi shku se u kanë e vetmja hapësirë ku na kena mujtë me nejt bashkë. Ku ke mujtë, ku e di sa kanë qenë 235 ulëse a 175 nuk e di saktësisht, po, domethanë, ni... osht' i njejt

teatër që ka ekzistuar. U kanë e vetmja hapësinë ku ke mundësi me qenë publik në vitet e '90-ta edhe me pasë ndjenjën kështu si, që po merr pjesë me nifara ngjarje kulturore.

Ne kemi shkuar me pa koncerte. A din, Dodona ka qenë e vetmja hapësinë ku ke mundësi me u bashkuar bashkë se në atë kohë ka qenë... në '90-tat ka qenë e kundërligjshme me ecë ma shumë se tri-katër veta në rrugë bashkë se ka qenë kështu si minisje apo provokim i protestave. Gjithmonë bojshim hajgare, "O' u bo ni protestë e vogël", si u bojshim pesë-gjashtë veta (qeshë). "Ku po shkojmë?" "Në protestë". Edhe... e Dodona ka qenë e vetmja hapësinë.

Po për mu ka qenë shumë interesant si sa e rëndësishme është humori edhe komedia në qat' far' rezistencën edhe qat' far' përditshmërinë e rezistencës. Kështu që më vjen keq që s'kemi merr asnjëherë me, Faruk Begollin me e vlerësuar për gjenialitetin edhe kontributin e tij në... jo veç ndërtimin e Fakultetit të Regjisë edhe aktrimit në Kosovë po krijimi i qasaj, mirëmbajtja e qasaj hapësire për krejt qat' vjet.

Anita Susuri: E në Prishtinë, në cilën lagje keni jetuar me familje?

Linda Gusia: Unë kom jetuar në Dardani, unë kom jetuar në Dardani. Kom shkuar në Shkollën Vladimir Ilc Lenini, ka qenë Shkolla Dardania ma vonë. Po Vladimir Ilc Lenini ka qenë kështu si shkolla, po më duket osht' hapë në '96-tën, '96-'97, qatëherë kur kom filluar unë shkollën fillore edhe ka qenë kështu ndër shkollat ma të bukura, ma të kompletuara në Prishtinë. E kemi pasë nifara' salla të edukatës fizike që ka qenë me dusha. Kemi pasë radion e shkollës që kryesisht na bërtitke drejtori për diçka (buzëqeshë).

Po ka qenë, domethënë, e kemi pasë në bibliotekë shumë t'mirë, e kemi pasë këtë sallën e shkencës që ka qenë, domethënë, interesant i kemi pasë nifara' Anatomia Grey, qysh i thojnë shqip? Edhe... domethënë ka qenë shumë shkollë e bukur edhe moderne. Ka qenë... na thojshin, "Shkolla që duhet m'i hjekë kpuat kur hijmë". Se kemi pasë pandufe kur kemi hi në shkollë. Po mandej ka qenë shumë jetë shkurte ajo, kështu.

Se në '99-tën në... kam qenë, s'po di në cilën klasë kam qenë qatëherë gjashtë-shtatë. Nihetë u bo nifara' muri mes serbëve dhe shqiptarëve në shkollë edhe diqysh ka qenë nifara', ai muri në shkollën temë fillore ka shënuar shumë çka. Ka qenë domethënë që nifara' segregimi mes shqiptarëve dhe serbëve, nifara' realiteti t'ri. Tash kemi më të si me thanë na kemi qenë 90% e shkollës kemi qenë shqiptarë e na kemi mbetë në pjesën kështu ma t'keqe të shkollës. Domethënë biblioteka, kjo salla e shkencës kanë mbetë në anën e serbëve.

Biblioteka ka mbetë në atë anë edhe na kemi mbetë në këtë anë e domethënë përnihetë i kemi pasë dyrtë të ndame. Deri atëherë për shembull kemi luftë edukatë fizike me, me serbët domethënë pa asni... shfaqen shumë t'mirë që e kom pasë në kat, Nalica, me Nalicën shpesh shkojsha në shkollë bashkë. Po domethënë prej ditës kur u bo muri, ka qenë kështu nifara' muri që është ndërtuar edhe mes

meje edhe saj edhe në mënyrë kshtu shumë, si me thanë, në mënyrë shumë të heshtun jemi, kshtu, s'kemi komuniku ma kurrë, a po?

Edhe kur jemi pa n'koridor të hymjes, se kemi qenë ni kat, gjithmonë ka qenë pak ni, kshtu, siklet prej saj sidomos po edhe prej meje se domethanë veç kemi, veç nuk kemi folë ma. Qajo muri ka ndërtu edhe muret e tjera të komunikimit me njani tjetrin. Muri manej ka shënu shumë çka. U kanë në '90-tat filloj mandej, në pranverë të qatij njejtis vit fillojnë helmimet. Helmimet i maj mend si periudhë ku e krijojnë ni ndarje edhe ma t'madhe.

E maj mend si nifar' segregimi shumë t'madh në mes shqiptarëve dhe serbëve, nifar' domethënë në kontekstin ku ma as nuk flasim, as nuk përshëndetemi. Për shembull m'kujtohet ni kojshi që poashtu kemi pasë relacione t'mira me to, veç e kemi pa n'lajme i cili thotë, "A shqiptarët janë aktruesit ma t'mirë n'botë, duhet me ju jep Oskar sepse aktrojnë mirë". Derisa për shembull në kontekstin e neve si fmi, si 12-13 vjeçar na kemi qenë shumë të traumatizun në shkollë sepse në shkolla të ndryshme ka pasë helmime.

Na e kishim shumë t'paqartë çka domethënë ajo. E shishim n'televizion vazhdimisht helmimit edhe mandej vazhdimisht ishte ni frikë që mos po dëgjojmë nifar' ere, mos, mos dikush nuk është t'u u ni mirë qat' ditë. Ka qenë nifar'...

Anita Susuri: Nifar' paranoje.

Linda Gusia: Po ka qenë, ka qenë ni lloj paranoje dhe ka qenë ni lloj frike. M'kujtohet ni frikë e pashpjegushme. Se e para m'kujtohet prindt tanë u munojshin me na mbrojtë prej, prej detaleve po m'kujtohet që u kanë kshtu ditë shumë dramatike. Domethanë marrja e pavarësisë, autonomisë së Kosovës në '89-tën ka qenë dramatike. Me tregu pak ma kronologjikisht, domethanë, '89-ta ka qenë qajo kshtu nifar', nifar' viti i çarjeve t'mdha, viti i transformimeve t'mdha. Viti kshtu si ndoshta ndër vitet ma traumatike t'jetës tem. Domethanë deri '89-tën n'përgjithësi jeta ka qenë ma e qetë.

Unë kom nejt shumë te gjyshi jem edhe te gjyshja jeme në Pejë edhe e kom pasë kshtu ni lidhje emocionale ma shumë me Pejën sesa me Prishtinën n'atë kohë se m'pëlqejke oborri i madh, pulat, qejt, macat, natyra. Prishtina ka qenë kshtu... Prishtinën e mbaj mend dimrit, e mbaj mend t'u lujtë me saja edhe qajo ndjenja e komunitetit, e mahallës ka qenë ndryshe në qytete ma t'vogla edhe ndryshe në Prishtinë. Po për shembull na kemi kalu krejt verën te gjyshi edhe gjyshja n'oborr e mandej dimrin, pjesën tjetër t'vitit në Prishtinë.

Po '89-ta ka qenë qashtu. I kom pasë dhjetë vjet e gjysë në '89-tën. '89-ta ka qenë vit shumë dramatik për secilin prej neve, a po? '89-tën jemi çu kshtu në mëngjes me tenka, domethanë në Dardani m'kujtohet kur kanë hi tenka n'këtë rrugën që është tash Rruga Bill Clinton edhe e di që jemi çu natën

dhe krejt familja ka qenë kshtu si n'heshtje t'u i ni tenkat t'u hi në Prishtinë edhe kshtu gjendja e jashtëzakonshme.

Prej qasaj dite domethanë m'kujtohet domethanë edhe qato protesta pak ma herët, m'kujtohet axha jem edhe krejt puntorët në, që kanë qenë në marshin... kjo ka qenë në shkurt, ka qenë para tenkave. M'kujtohet krejt '89-shi fillon kshtu me ngjarje shumë dramatike. Me shumë protesta, me shumë... tashti, domethanë, e kom ni skenë kshtu shumë n'kujtesën teme '89-shi... na kemi pasë banesat e kaltërta e kemi pasë ni dritare kshtu që shihke, e ka pasë pamjen shumë t'mirë në kurriz po edhe shihke përtej te rruga Bill Clinton. M'kujtohet t'u ardhë punëtorët, protestues prej krejt Kosovës. Që ecin n'kamë.

M'kujtohet axha jem nalet te na n'banesë. Edhe domethanë kanë ecë ata prej Pejës me kolektivin e tyne të Fabrikës Trepça. M'kujtohet t'u mundu m'i deshë kpucat e t'u mos mujtë m'i deshë kpucat se ju kanë ajë kamtë. M'kujtohen qato skena të protestave, të pjesëmarrjes n'protesta. M'kujtohet kshtu dëshira shumë e madhe me marrë pjesë n'protesta (qeshë). E kom pasë kshtu nifar' shtytje edhe nxitësi me participu, me qenë në proces. Domethënë '89-ta kanë qenë kshtu dramatike, përveç me qit' episoden e tenkave.

Po edhe n'përgjithësi '89-ta kshtu përneherë osht' nifar' zyrtësie si nifar' kalimi shumë i madh në mes gati si n'kry tem e shoh para '89-tes si me shumë ngjyra, me shumë natyrë, me hare. E '89-ta e tutje është kshtu shumë e zyrtë, nifar' ndjenje e klaustrofobisë, nifar' ndjenje e ndryshimeve t'mdha. Po për mu si dhjetë vjeçare ndryshime shumë dramatike ku gjithçka fillon m'u ndryshu, po gjithçka fillon në mënyrë shumë dramatike me ndryshu. Prej ambientit tem n'shkollë ku bohet qajo ndarje me mur, në kontekstin e shpisë.

Nana jeme si krejt tjetër marrin... nana jem ka punu në Komunën e Prishtinës si juriste edhe me 03 shtator 1990-tes merr pjesë në këtë protesten e famshme të madhe të organizune nga Sindikata e Punëtorëve të Kosovës ku të gjithë refuzojnë me dalë me 03 shtator. Edhe 03 shtatori osht' nifar' dite që m'kujtohet që shikojshim prej dritarës edhe ishte nifar' dite e heshtjes shumë të madhe, a po? Sepse osht' diqysh sikur na refuzum me participu n'jetën publike.

N'fakt m'kujtohen krejt protestat e viteve të '90-ta, m'kujtohet që domethënë ni prej protestave që m'kujtohet shumë që unë merrsha pjesë me shumë zemër u kanë protesta kur dilshim kshtu me tenxhere edhe me sahana në ora 07:00. Në momentin kur osht' mbyllë Radio Televizioni i Prishtinës në formë të dhunshme, m'kujtohet që ai terri informativ, protestat kanë shënu si, na e kemi si stimulu qat' protestën thujse me qenë n'burg edhe perime ka qenë si ndjenjë thujse je n'burg.

Protesta ka qenë m'kujtohet... ka pasë protesta të ndryshme që mendoj që kanë qenë shumë kreative. Edhe për mu kanë qenë shumë formative. M'kujtohet që për mu mendoj edhe sot arsyeja pse marrë pjesë në protesta edhe pse protestat i konsideroj si shumë t'rëndësishme për shprehjen e vullnetit

t'libër është pikërisht se n'qato vite domethanë qajo pjesëmarrja kolektive në protesta ka qenë kështu si forma e vetme e reagimit, si agjensia e vetme. Si ndjenja që ti në nifar' mënyre je t'u rezistu.

Për mu ka qenë shumë e rëndësishme me tregu qat' rezistencë. Me... unë i mbaj mend të '90-tat si vite të rezistencës, a po? Pa marrë parasysh sa, domethanë, shumë njerëz ma bojnë, "Po ti p'e man mend rezistencën po na kemi qenë poashtu viktima". Natyrisht që kemi qenë viktima po kemi qenë poashtu viktima që kemi rezistu edhe formimi jonë politik ka fillu për, sidomos për gjeneratën tem qatëherë. Domethanë krejt '89-shi, krejt '90-tat kanë qenë vite të protestes. Domethanë deri '91-ten kanë qenë vite të protestave të ndryshme.

I mbaj mend këtë protestën kur e nalshim dritën në ora 07:00. Këtë protestën t'u e rezistu këtë terrin informativ me mbylljen e Radio Televizionit të Kosovës. Babi jem ka punu në Rilindje edhe m'kujtohet që për babin edhe për gjithë neve ka qenë Rilindja që ka mbetë... në fakt Bujku mbetet e vetmja formë e informimit. Babi ka pasë ni leje t'veçantë. Kta që kanë punu në Bujk kanë mujtë me dalë në orë policore. M'kujtohet ai tmerri i orëve policore.

Nana jem n'qat' kohë ka qenë poashtu shtatzane në '89-ten me vllaun tem t'vogël. Ka qenë qajo frika e orës policore, faktit që nana jem ka qenë shtatzane, faktit që kanë fillu, domethanë, gjithë ato protesta, krejt kto, krejt '89-shi, '90-tat kanë qenë vite të... vite jashtëzakonisht shumë dinamike dhe vite me shumë ndryshime radikale, a po? A po mënyrën se si qysh kemi mendu dhe qysh kemi reagu, a po? Protestat merrshin forma t'ndryshme. I nalshim dritat në ora 07:00. Ka qenë nifar' terri dilshim n'ballkon me kqyrë kush i ka nalë, kush ka harru m'i nalë dritat prej kojshive.

Mandej protesta që kom marrë pjesë ma së shumti ka qenë qikjo me tenxhera me çelsa, me kështu. Domethanë ka qenë ni, ni... m'kujtohen echo-t që u bojshin në Dardani prej protestave me tenxhere edhe qajo solidariteti edhe ndjenja e komunitetit që për mu mandej mbetet e rëndësishme. Mendoj që qajo diqysh si merr formë qatëherë.

Anita Susuri: Kur po na tregon për krejt këto ngjarje politike që kanë ndodhë që kanë ndiku shumë në jetën e krejtëve që kanë qenë. Po po më intereson edhe krejt kta ju si, si vajzë e re, si domethanë memoria për me pasë jetë kulturore, shoqërore, qysh ka qenë kjo n'krejt këtë krizë?

Linda Gusia: Po thom deri '89-sha, '92-sha janë shumë dinamike po unë jom shumë e vogël n'atë kohë. '92-ten osht' referendumi. Mu m'kujtohet referendumi edhe prindt e mi kanë marrë pjesë n'referendum. M'kujtohet kojshit e mi t'u folë për referendum. Domethanë u bonën tri vjet rezistencë aktive. '92-ta mandej vjen si nifar' fazë tjetër. '92-ta, '93-ta domethanë nuk ka ma protesta, nuk ka ma, domethanë rezistenca paqësore bohet shumë pasive.

Në fakt në '92-ten unë e kryj shkollën fillore edhe regjistrohna tash në shkollë të mesme. M'kujtohet '92-ten, '91-ten mbyllen në fakt, '90-tat mbyllen kto shkolla e mesme, Universiteti i Prishtinës edhe në

‘91-ten osht’ kshtu si viti jem i fundit n’shkollë fillore. Osht’ goxha problematike ‘90-ta, ‘91-ta. Janë dy vitet e fundit t’shkollës fillore, vite kshtu me shumë sfida. M’kujtohet atë mramjen e gjysës së maturës s’e patëm organizu hiç veç u patëm mbledhë te ni shok edhe na pat’ ardhë policia edhe prindt tanë e di që m’kujtohet që ka qenë ora policore. Tash as nuk mujshim me shku n’shpi as asi...

Domethanë ka qenë nifar’ periudhe... po po du me thanë festat kanë vazhdu. Na kemi bo festa. Ka qenë koha, koha e kapërcimeve t’madhe. Frikës t’madhe prej prindërve, prindt janë frikësu gjithmonë që mos po na ndodhë diçka po t’njejtën kohë kanë pasë ma shumë mëshirë për neve se ne kemi qenë kshtu fmi të, të gjendjes së jashtëzakonshme. M’kujtohet që gjithmonë kanë qenë, po gjyna, edhe gjithmonë ka qenë qiky diskutimi në mes sigurisë tonë edhe nevojës tonë për me qenë fmi edhe t’ri.

‘93-ta, ‘92-ta po thom unë e kryj shkollën fillore edhe tash vjen koha m’u regjistru n’shkollë t’mesme. M’kujtohet në shtator të ‘92-tes domethënë na shkojmë para shkollave, bojmë protesta. Unë u pata regjistru në Sami Frashër, Ivo Lola, në Ivo Lolë. Patëm shku para Ivo Lolës edhe me protesta dhe m’kujtohet kshtu një prej atyne momenteve ku na tash pritshim me hy në msim po nuk na, nuk na lejshin. U bo nifar’ koridori me polic edhe mandej hynën nja dhetë veta që hynën n’shkollë.

Mu m’kujtohet kshtu ndjenja e qatij, domethanë, na ishim aty krejt fmi t’u dashtë me hy n’shkollë edhe policia t’u ndalu kshtu fizikisht me hy n’shkollë edhe dhjetë veta që na përqeshnin t’u hi n’shkollë, dhjetë serb t’u hy n’shkollë. M’kujtohet që qikjo ndjenja e padrejtësisë kshtu revolta që vjen prej qasaj ndjenje të padrejtësisë së madhe. Semestrin e ‘92-tes nuk shkojmë po m’doket n’shkollë hiç. Tentojmë disa here me bo protesta po nuk, domethanë, osht’ konsolidimi i shtëpive shkolla edhe m’kujtohet që ka diskutime të ndryshme se qysh po ia bojmë.

M’kujtohet që okej tash shkolla është në, e kemi... babi punojke në Bujk edhe m’kujtohet pat’ ardhë lajmi hala pa dalë gazeta që okej shkollat janë qështu. Domethanë me Gazetë të Bujkut u informojshim ku me shku n’shkollë, çka me bo. Për mu për shembull Vranjevci, Kodra e Trimave ka qenë hera e parë që kom shku n’atë pjesë t’qytetit edhe m’kujtohet ni shpi e madhe m’i shiqu emrat. Ka qenë shpi. Na ishim në protesta para shkollës t’madhe edhe tash okej qikjo shtëpia e Herticëve, qikjo është shkolla jonë e ardhshme.

Është shumë interesant sa shumë adaptohesh. E kujtoj që s’e kemi bo shumë muhabet veç kemi qenë t’lumtur që, a din, jena t’u shku tash n’shkollë t’mesme, po na doket vetja ma t’mdhoj. Na kemi qenë qajo gjenerata e parë që fillojmë, domethanë, ka qenë ni tentim ma herët po me gjeneratën teme fillon mësimi në shtëpitë shkolla. M’kujtohet kur kemi shku për herë t’parë ka qenë kshtu si shtëpi private. Në fakt herën e parë që kemi shku ka pasë kshtu edhe mobile. Sepse familja e Herticëve e kanë bo atë shpi për shpi t’vetën.

Ka pasë kshtu, hala s’kanë mrrë me hy, i kanë rregullu do dhoma. Ka qenë shtëpi krejt e re. Kur na kemi shku për herë t’parë ka pasë hala mobile. Manej m’kujtohet mas naj ni jave a dy prej shumicës t’klasës

i kanë hjekë mobilet dhe kanë pru shpuza kshtu m'u ulë sikur nëpër oda. M'kujtohet nana jeme... sepse s'ka pasë mjaft shpuza sepse kemi qenë shumë, kemi qenë 40 me ni klasë. Nana jem ma pat' bo edhe nifar' si si me thanë si syngjer t'vogël si kshtu që e pat' maru vet për me marrë unë me veti n'klasë po që ish tamon me madhësinë e çantës që unë e kisha.

Se unë s'dojsha me marrë çantë tjetër. Thojsha, "Nëse e nxen n'qit çantë e marr, nëse jo", se halli saj ka qenë gjithmonë mos po ulna n'tokë e mos po ftofna (qeshë). Domethanë ka qenë qajo, s'po di, qajo procesi m'i deshë kpuat me hi n'qat' shpi që ka pasë shumë dru edhe llamarin. Ka pasë shumë pula n'oborr. Ka pasë qatëherë n'fillim edhe ni lopë m'doket, po pulat kanë qenë kshtu konstante. Ka qenë edhe qajo nevoja për me qenë t'sjellshëm.

Se na kemi qenë domethanë fmitë e Sami Frashërit kanë qenë ma t'lazdrun, ma t'përkëdhelun, ma t'qytetit. Tash përneherë u kanë qajo që okej na tash jena në ni shtëpi të dikujt tjetër, nuk jena n'shkollë përnime edhe duhet me qenë pak ma t'kujdesshëm edhe pak ma t'vëmendshëm. Po domethanë krejt procesi me shku n'shkollë ka qenë proces i gjatë. M'kujtohet unë u nissha prej Dardanisë, Mimozen Jupën e kom pasë shoqe t'ngushtë. Mimoza m'pritke ktu te qendra mandej shoqet e tjera i kemi pasë kshtu. U takojshim rend, rend edhe u mbledhshim bashkë.

Nuk na merrshin autobusat me shku se na ishim shumë edhe i nxishim autobusat kshtuqë nuk na merrshin autobusat. Po në të njejtën kohë kjo ka qenë nifar' periudhe ku shumica prej nesh s'i kemi pasë prindtë n'punë. Se fillova me të tregu, po keq prej rrëfimit në rrëfim se rrëfimet e të '90-tave janë pak si të përzine me njana tjetren se ka shumë ngjarje dhe të gjitha ndodhin përneherë. Nana jeme e hup vendin e punës për shkak se merr pjesë në protestat e 03 shtatorit 1990. Domethanë veç e merr ni letër mas dy ditëve që është tepricë teknologjike. Edhe për nanën tem kjo ka qenë lajm shumë i vështirë. M'kujtohet që...

Nana jem ka qenë gjenerata e parë e grave që ka kry, në familjen e vet që e ka kry fakultetin. Nana jem ka qenë juriste, ka qenë shumë krenare me idenë e pavarësisë ekonomike të grusë. Me faktin që ka qenë gru që ka pasë rrogën e vet, që ka punu prej vitit të tretë të fakultetit, që ka qenë e pavarur ekonomisht. E për to qajo humbja e vendit t'piunës ka qenë kshtu shumë dramatike edhe shumë traumatike. Domethanë është edhe qikjo, qikjo elementi tjetër i çka ndodhë sidomos me gratë n'atë kohë, në vitet e '90-ta që hupin vendin e tyre t'punës edhe që hupin qat' stabilitetin ekonomik që kanë pasë. S'po di tashti, jom t'u t'i tregu dy histori të ndryshme, po mendoj histori të ndërlidhuna po paralelisht.

Anita Susuri: Kshtuqë nana nuk ka vazhdu me punu diçka tjetër?

Linda Gusia: Jo ka qenë e pamundun me vazhdu me punu domethanë. Shumica e grave në vitet e '90-ta që kanë punu n'punë t'shtetit e hupin vendin e punës, ni numër shumë i vogël i tyre vazhdon. Privatisht shumë pak. Domethanë privatisht çka ka qenë mundësia? Me hap ndonjë dyqan. Ni grup i

vogël i tyne vazhdon me ni lloj forme të aktivizmit edhe me organizime t'ndryshme. Unë e kom pasë vllaun shumë t'vogël i cili lind shumë para kohe edhe nana jeme osht' kshtu kryesisht fillimin e viteve të '90-ta merret me vllaun tem.

Për mu osht' shumë e rëndësishme qajo dinamika që krijohet, solidariteti që krijohet mes grave në hymje në Dardani. Domethanë shumë gra të cilat edhe kanë punu ma përpara po edhe kanë dalë prej punës e kanë pasë nifar' rituali të solidaritetit edhe krijimit të nifar' komuniteti të t'ri. Çdo herë në ora 11:00 kanë pi kafe bashkë. Domethanë te njana prej grave në hymje. Ky ka qenë nifar' kshtu te qito kafet e kojshikeve të orës 11:00 n'hymje teme kanë qenë shumë t'rëndësishme se kanë qenë shumë diskutime interesante për jetën e përditshme të viteve të '90-ta.

Kto gra, tash gra të cilat shumica prej tyne gjenerata e parë e grave që kanë punu, të cilat kanë qenë shumë të investume në krijimin e nifar' karriere, në nifar' ideje që puna ta jep nifar' emancipimi shoqëror edhe shkolla edhe ato. Tash kto krejt mesin në atë monotoninë e domesticitetit edhe shtëpisë po në të njejtën kohë në ni periudhë ku kushtet ekonomike për të gjithë janë shumë t'kqija. M'kujtohet domethanë ka pasë kshtu recetat e torteve me ni vo, recetat e ajrokremi, recetat e kshtu bohen kshtu, e xhemave. Bohet në ni formë të komunikimit po edhe nifar' solidariteti jashtëzakonisht i madh me t'gjithë hymjen edhe anëtarët e hymjes.

Mu m'kujtohet kshtu në mënyrë shumë spontane, po edhe shumë spontan, a po? Se solidariteti jo spektakular, solidariteti jo me nifar' akti të mëshirës poashtu, nifar' solidariteti shumë organik. M'kujtohet shkojshim... na bojke, "Shko çoja Tezes Kadishe qito llokuma sot", apo, "Çoja qito ekstra vo". Domethanë secila që kish naj far' sfide qato ditë të mujit gratë tjera në hymje u solidarizojshin. U solidarizojshin me libra, u solidarizojshin me tesha. Në momentin që t'bishin çizmet e vogla janë konë edhe nja dhetë njerëz tjerë të cilët kemi prit kshtu me rend me ia jep çizmet, me ia jep jaknen.

E kjo ka qenë ni organizim i madh prej kojshikeve a po? Të cilat janë siguru që qajo jetesa edhe mirëqenia vazhdon me ekzistë po edhe ndërtojnë një solidaritet jashtëzakonisht të madh me njani tjetrin. Kto bohen nifar' si grupi përkrahës për njana tjetren emocionalisht sepse t'gjitha kanë vështirësitë e veta po edhe financiarisht edhe domethanë të gjithat janë t'u rritë fmi në ni kontekst jashtëzakonisht të dhunshëm edhe në ni shoqëri jashtëzakonisht të brishtë.

Kshtuqë kur e menoj qato kafet e orës 11:00, qajo solidariteti shumë organik që krijohet mes grave edhe mes njani tjetrit menoj që është kshtu si boshti kurrizor edhe menoj që shtylla e qasaj rezistence civile. Sepse na për shembull çka bojmë në të '90-tat, ne na jepnin ksi detyra me pastru hymjen a po? E kemi pasë nifar' kshtu se ne kemi qenë si 60% shqiptar n'hymje 40% serb apo 65% diçka qashtu. Na kemi qenë pak ma shumë po kemi pasë edhe shumë familje serbe në hymjen teme. Ka qenë gjithmonë qajo mos pajtimi me, domethanë na refuzojshim me pagu taksa, refuzojshim... kshtuqë nuk kish ma mundësi m'u pastru hymja.

Mandej një prej akteve që bojshim na çikat e reja është që dilshim me pastru hymjen prej naltit deri poshtë. Edhe u kanë kshtu si nifar'... mandej ni policimi që e bojshim kushdo që gjun berllog. U kanë shumë e rëndësishme me i shpalos, po mendoj, po i shpalosi në mënyrë të qëllimshme qito detajet e vogla sepse ka qenë nifar' përkushtimi dhe investimi i të gjitha gjeneratave. Diçka që nuk mbrrin me u përcjellë, diçka që nuk mbrrin me u artikulu, diçka që nuk mbrrin me u riprodhu në krejt tentimet tona për m'i rikriju, rimendu apo dokumentu të '90-tat është qito aktet e rezistencës së përditshme edhe qito forma të solidaritetit që krijojnë qat' far' kohezionin social edhe përbashkimin.

Që mendoj që është motorri kryesor i faktit që rezistenca paqësore edhe pse përfundon me luftë në Kosovë, len shenjë në kontekstin e pas luftës edhe krijon nifar' sensi t'madh të përkushtimit edhe kontributeve t'mdhaja. Mendoj që kjo është shumë e rëndësishme me u shpalosë, shumë e rëndësishme me u dokumentu edhe shumë e rëndësishme me u kujtu, a po? Qito akte t'vogla të solidaritetit me njani tjetrin, akte t'vogla të rezistencës, forma të ndryshme se si jemi, si jemi mobilizu.

Pjesa e Dytë

Linda Gusia: M'u kthy tash te shkolla a po? Domethanë prej qasaj shilte t'vogla që na bojke nana, gurabijave që i merrshim i ndajshim me klasë, kifleve që na marojshin. Se tashti na ecshim nja ni orë e diçka deri në Vranjevc. Edhe tash ka qenë kshtu si nifar' udhëtimi. U pregaditshim me kifile. Po tashti gjithmonë kanë qenë kto kifile për s'paku gjysën e klasës ose për ni numër t'madh t'klasës se s'munësh me hangër vet, "S'bon me hangër vet". Ka qenë kshtu nifar' solidariteti me gjithë të tjerët.

Ndërtimi i shtëpive shkolla masi unë jam gjenerata e parë kshtu, ka qenë ai akti i krijimit të shtëpive shkolla. M'kujtohet në vitin e parë ka qenë kshtu nifar' kërkesë nëse prindt e juj' mund m'i dhanë, për shembull, m'kujtohet atëherë kah dhetë marka ose sado që mujnë m'i dhanë për shtëpitë shkolla. Edhe për ndërtimin e... m'kujtohet qat' vit po m'doket n'fillim profesorat tonë nuk u pagujshin fare. Mandej e kanë marrë nifar' rroge simbolike prej këtij fondit tre përqind.

Po ka qenë nifar' solidariteti. Domethanë na gjithmonë kemi pru sende në shkollë edhe kemi, m'kujtohet, e kemi pastru shkollën, e kemi mirëmbajtë shkollën. Domethanë shkolla ka qenë mandej si shpi e jona. Osht' shumë interesant me menu që qajo hapësirë mandej fakti që ka qenë shpi e ka kriju, ka kriju relacione t'reja. Po përderisa për shembull n'shkollë fillore m'kujtohen relacione shumë formale. Sepse hapësira ka qenë formale a po? Tavalina, tabela krijon nifar' dinamike shumë formale.

Në... te Herticët domethanë qiky formaliteti sfidohet a po? E para jena ulun krejt afër njani tjetrit, mbështetun n'kamte e njani tjetrit. Po e para fizikisht domethanë qajo distanca që ka ekzistu mes neve zhduket a po? Domethanë na vazhdimisht kemi bo hajgare, "Kujt po i vjen era kamve? Kush duhet m'i ndrru çorapet?" Kena pru çorape ekstra me veti n'shkollë. Thojshim, "Ti ndrruj çorapet". Qajo afërsia

fizike ka qenë shumë e madhe me njani tjetrin po t'njejtën kohë edhe arsimtarët kanë hi me ni dhomë sa kjo me 30 nxanës a po?

M'kujtohet kur u çojshin n'kamë me ni tabelë të vocër. Apriori, humbet formaliteti. Shumë prej klasëve poashtu bohen klasë për ngjarje të cilat ndodhin. Sepse krijojnë nifar' intimiteti. Mendoj që është shumë e rëndësishme me e kap edhe këtë element kur flasim për shtëpitë shkolla. Ai intimiteti që krijohet edhe që shpija e jep, domethanë, veç fakti që jemi në ni shpi fizikisht nuk jemi në ni objekt formal të shkollës krijon poashtu relacione t'reja edhe tjera.

Nifar' relacioni të intimitetit, nifar' relacioni të madhe të komunitetit, nifar' relacioni ku dallimet që i kishim me njani tjetrin klasore, ideologjike u shkrishin pikërisht për shkak të atij intimiteti t'ri fizik që e gjejmë. Na tash u ulshim n'tokë apo u kthejmë krejt bashkë n'shpi. E kishim si me lagje. Ecshim në forma t'caktune grupe, grupe.

Anita Susuri: A keni mendu ndonjëherë për shembull ose keni bisedu me shoqni qysh kish qenë nëse ishit kthy menihërë në institucione tash? Qysh ishit adaptu?

Linda Gusia: Në fakt m'kujtohet menihërë mas luftës kur u dashtë me shku me nxjerrë ni leternjoftim t'ri edhe m'kujtohet që u kanë kshtu... e para qajo domethanë i vetmi kontakt me çfarëdo lloj forme të institucioneve publike ka qenë kur unë u dashtë me nxjerrë leternjoftimin që ka qenë shumë pak para luftës. Domethanë ka mujtë me qenë '97-ta a diçka kur e kom nxjerrë leternjoftimin për herë t'parë. E di që u kanë kshtu nifar'... kom shku me babin edhe ka qenë kshtu nifar' frike, nifar' që ka pasë shumë polic edhe domethanë veç me hy fizikisht me ni hapësirë të tillë ka qenë kshtu ni pa rehati.

M'kujtohet për herë t'parë kur kom ardhë mandej... se unë e filloj fakultetin në fakultetin shpi fakultet. Po mandej mas luftës vazhdojmë ktu në këtë objekt ku jom edhe sot. M'kujtohet kur kom hi për herë t'parë domethanë veç hapësira t'jepke ankth. Kur folsha me njerëz tjerë të gjeneratës tem osht' qajo fakti që na në fakt gjatë krejt '90-tave kemi ekzistim veç në hapësira private dhe jemi mbledhë vetëm në hapësira jashtëzakonisht të vogla, klaustrofobike.

Na edhe kur kemi bo neja, kur kemi bo kshtu, kanë qenë ja në shpija ja në kafe shumë t'vogla, në hapësira shumë t'vogla. Gjithmonë kanë qenë hapësira si semi private. M'kujtohet që hera e parë që unë kom hy se tash mas ni kohe, unë e para kom qenë fmi në të '80-tat po na as n'spital s'kemi shku, a po? Edhe kur kemi pasë nevojë për mjek kanë qenë, kemi ardhë ktu te Nëna Terezë apo ka qenë si shtëpia të ni mjekut që e njohim që kemi mjek familjar edhe shkojmë te shpija. Aty ai na ndëgjojke. Axha Kosufci ai ka qenë mjeku i familjes që shkojmë për gjithçka. Po shkojmë n'shpi te ai m'u vizitu edhe shumë prej neve qashtu. Domethanë familjariteti, hapësira ka qenë hapësira e shtëpisë.

Kalimi pastaj në hapësira formale ka qenë pak si dezorientus. Mendoj që na bon edhe si gjeneratë pak ma rebele dhe si gjeneratë jo shumë konfort me çfarëdo lloj forme të institucionalizuar. Mendoj që thellë gjenerata jem është shumë anarkiste. E kena kshtu ni ideje të do it yourself se krejt çka kemi

domethanë krejt rrita jonë, krejt historia jonë domethanë edhe pse në synim të ndërtimit të institucioneve edhe shtetit të Kosovës gjithmonë ka qenë kshtu si shumë komunale. Edhe shumë e bone në hapësina jashtëzakonisht t'vogla edhe gjithçka kemi bo vet.

Po thom, jemi shku e kemi fshi shpinë shkollë a po? Jemi shku me Emine Valën. Na kemi qenë me Eminën në redaksinë e Feniksit në '94-ten mas nja dy vjetve. Kemi dashtë me bo nifar' reviste të shkollës edhe...

Adea Batusha: A e keni themelu ju?

Linda Gusia: Po. E kemi themelu bashkë me profesorin Nazim Lleshi. Profesori Nazim Lleshi është profesor i frangjishtes dhe i latinishtës në Sami Frashëri. Ka qenë kshtu si profesori ma inspirues për t'gjithë neve. Mendoj që njana prej arsyeve që kom përfundu vet në edukim osht' se e kom pa rëndësinë e madhe me pasë ni person i cili krijon hapësina për njerëz tjerë. Po edhe profesori Nazim e ka bo qata me nifar' lehtësie të madhe edhe me njifar' dashamirësie shumë t'madhe.

Ka qenë ni dhomë në shkollë ku ka qenë shumë e vogël për me mbajtë msim. Në '94-ten dikush na fal ni kompjuter. Nuk e di saktësisht kush ia fal shkollës ni kompjuter, po osht' tash ni kompjuter. Na me profesorin Nazim kemi pasë gjithmonë shumë... profesorin Nazim, me profesorin Klinaku, o my god qysh e pat' emrin? Profesorin e kimisë dhe astronomisë. Me profesora... se s'po m'kujtohen shumë emra, unë jom shumë e keqe me emra po profesori i historisë ka qenë njëri prej profesorave ka qenë njëri, profesori i anglishtes. Kanë qenë profesora që kanë qenë shumë t'afërt me neve.

Po profesori Nazim domethanë ka qenë prej atyne profesorave që gjithmonë na bjen libra shtesë. N'atë kohë na s'kemi pasë biblioteka gjithmonë jemi nvar prej bibliotekave personale t'dikujt. Kur kemi marrë me lexu ni libër gjithmonë ka qenë... unë gjithmonë kom qenë jo shumë pedante me libra, hala kom qef m'i vizatu librat m'i shkru. Po në të '90-tat u dashtë me hap librin po jo me hap shumë se me bo me dëmtu pak librin nuk ta huazon ma personi t'ardhmen.

Kshtuqë m'kujtohet kur i lexojshim librat nuk i hapshim shumë. Kaniherë kemi mbetë gjithë natën t'u lexu librin se kemi kthy librin n'mëngjes që me mujtë me lexu dikush tjetër. Nëse s'e ke lexu qat' natë ke mbetë pa e lexu librin. Po profesori Nazim ka qenë prej atyne profesorave që gjithmonë ka pasë ni çantë edhe n'atë çantë ka pasë gjithmonë shumë libra. Erich Fromm-in m'kujtohet që e kom lexu prej tij, Frojdit. Kto diskutojshim për interpretimin e andrrave, gjanave t'ndryshme, mitologji mandej. Profesori ka qenë kshtu njohës i mirë i mitologjisë greke. Diskutojshim shumë mitologji.

Mandej latinisht u duhke me mësu shumë fjalë latine edhe tash kur i interpretojshim kshtu. Po profesori ka qenë prej atyne që na jepke çelsat e qasaj klase t'vocël n'fund t'koridorit që nuk mujke m'u përdor për msim. Qaty kemi fillu m'u mbledhë ni grup i neve. Unë, Emine Vala, Mimoza Jupa,

Dardane Selmani, Besart Visha. Domethanë redaksia, arti. Ni grup i nxanësve që kishim ma shumë energji se nxanësit me u marrë me kshtu aktivitete ekstra kurikulare.

Rrishim qaty derisa... tash na t'njejtën kohë duhet me theksu që kqyrshim shumë MTV. Që kqyrshim shumë televizion. Domethanë n'atë kohë se prej orës 06:00 ka qenë e rezervuar për prindt e tanë me kqyrë lajme maratonike. Kur fillojke prej orës 06:00 lajmet e TVSh-së, mandej, jo në 05:00 fillojke me Deutsche Welle, mandej fillojshin kshtu lajme deri në ora 10:00. Në mramje kshtu lajme shqiptare, lajme serbe. Domethanë u kanë shumë me rëndësi m'i përcjellë të gjitha informatat. Baba jem hala e bon, i përcjellë të gjitha informatat edhe hala ngon lajme prej orës 06:00 deri në ora 08:00 kshtu në mënyrë kshtu të përditshme.

Paradite në mëngjes e kishim kohën ku, masdite e kshtu, e kishim kohën kur mujshim me kqyrë MTV, domethanë nifar' realiteti i shkëputun. Qikjo terri informativ nënkupton që tash secili prej neve, prindt tanë detyrohen me ble qishtu satelita. Kaniherë e blejke ni kojshi satelitin edhe tash nja katër kojshi u lidhshim me to edhe u detyrojshe me kqyrë çkado që kqyrë ai. Po ka qenë nifar' marrëveshje, "A bon bre kojshi?" Po MTV ka qenë kshtu për vllaun tem, për mu, për gjeneraten tem qatëherë '92-ta kur na mujshim me kqyrë MTV me satelit.

Ka qenë mandej ni realitet i ri, ni muzikë e re, nifar' identifikimi i ri me shënjus t'ri. Do referenca t'reja për neve. Na mësojmë anglisht me anë të MTV-së, mësojmë, imitojmë, dojmë me qenë si njerëzit e tjerë. Po e kem qat' grup t'referencave. Feniksi bohet kshtu si nifar' tentimi për me bo diçka që osht' veç e shkollës po është veç funn edhe nuk ka politikë. Shumë interesant. Në retrospektivë domethanë m'kujtohet që kemi qenë shumë politik, a po? M'kujtohet domethanë ka qenë kshtu si t'u shku n'shkollë edhe t'u çky postera të Millosheviçit nëpër qytet, a po?

Me këtë Mimosen shoqen teme t'u shku n'shkollë e t'u çky postera e t'u bo qisi vandalizime. T'u na njekë e t'u ikë e kshtu. Domethanë kemi qenë shumë politik e shumë m'doket interesant që Feniksi kur e lexoj kaniherë ose kur e kqyri thom ooo {onomotope} (mbyll sytë). Po ka qenë kshtu si ikje. Ka qenë si nevojë me tentu me qenë normal edhe me tentu me qenë, me tentu me qenë... se aty ka pasë për shembull m'kujtohet e kemi pasë shumë t'rëndësishme me folë për STD, e kemi pasë shumë t'rëndësishme me folë për... domethanë e kemi pasë t'rëndësishme m'i thy do tabu. Mendoj që qajo ka qenë qajo formë me bo qato. Feniksi ka qenë qashtu me tripa palidhje po edhe veç me sene t'shkollës.

Adea Batusha: Qysh u dok ni numër me ditë kshtu?

Linda Gusia: A s'e keni a?

Adea Batusha: Jo.

Linda Gusia: Okej, muj me gjetë dikund.

Adea Batusha: Veç me pa kshtu.

Linda Gusia: Okej. Në faqen e parë ka qenë Arta Dobroshi në numrin e parë. Arten e kemi pasë shoqe. Te Arta Dobroshi i kena bo nejat ma t'mira krejt t'gjeneratës. Prindërit e Artës edhe Gencit Dobroshit kanë qenë kshtu, e kanë pasë shpinë e madhe në Dragodan edhe gjithmonë krejt mas shkollës apo për vikend gjithë kena shku te Dobroshët, krejt Prishtina po m'doket me neja t'ndryshme. Po Arta ka qenë... çika që kanë qenë t'përfshine qashtu që kemi nejt në Feniks. Numri i parë... i gjej numrat, po mendoj i kom t'skanune dikah.

Edhe Feniksi osht' kshtu... po mendoj e kemi përcjellë Miss Kosovën (qeshë). Po ka aty edhe sene shumë interesant. Eminja për shembull pat' mrrri me folë me Ismail Kadaren kur ka qenë, ka qenë po m'doket në Prishtinë. Jo, Eminja ka qenë në Gjermani, qishtu diçka. Po domethanë ka pasë qishtu gjana t'ndryshme në Feniks. Feniksi ka qenë nifar' mënyre na me... drejtorit t'shkollës nuk i ka pëlqy shumë çka kena bo.

Adea Batusha: Pse?

Linda Gusia: Po ka qenë kjo fryma se tashti na dojshim, dojshim me shti aty elemente shumë ma progresive edhe atij iu duke që s'ka nevojë, që duhe me pasë sene patriotike. Po mendoj na kemi qenë shumë të kujdesshëm. Kemi qenë kshtu në përgjithësi fmi shumë t'mirë edhe jemi mundu... kur e mendoj vetën kshtu në retrospektivë, edhe pse kena mendu që kena qenë rebel kemi qenë kshtu shumë t'mirë, nxanës t'mirë a po? Kshtuqë drejtori e kish kshtu Feniksi iu duke... tash për shembull m'kujtohet kur folshim me profesorin Nazim për emrin.

Feniksi ka qenë kshtu prej mitologjisë edhe ideja që na jemi si Feniksi a po? Që na jemi... e qajo ideja e rezistencës ka qenë shumë e gërshetune me identitetin tonë, qajo ideja që nuk jemi viktimë. Mendoj që edhe Feniksi edhe krejt çka kemi bo në shkollë t'mesme ka qenë nifar' forme e refuzimit m'u identifiku me qat' pasivitetin dhe viktimizimin. Mendoj që çkado që kemi bo ka qenë kshtu si nifar' akti me tregu që s'jemi viktimë, a po? Qato nejat që i kemi bo i kemi pasë neja dhe që kemi dalë, që jemi mbledhë gjithmonë kanë qenë poashtu domethanë nifar' si akti i rebelimit.

Koncertet mandej. Koncertet kanë qenë kshtu formë shumë e rëndësishme e jona e mbledhjes po edhe e artikulimit politik. Kanë qenë rock, kanë qenë... krejt ai stili i jetesës ka qenë bunti dhe rebelimi i gjeneratës tem i cili është mirëmbajtë n'qito far' hapësina shumë t'vogla.

Anita Susuri: Osht' edhe ni diçka interesante që kena dëgju prej gjeneratës t'juj osht' ardhë, pak ma t'moshun se t'gjeneratës t'juj tash s'pe di, për Kurrizin që ka qenë?

Linda Gusia: Po. Kurrizi ka qenë shumë i rëndësishëm për ne. Kurrizi ka qenë shumë afër shtëpisë. Tashti dinamika ka qenë ndryshe mbi Kurriz, dinamika ka qenë ndryshe nën Kurriz. Mbi Kurrik kanë nejt kto grupet që janë ma alternative, ma rojera, ma problematike mandej kemi shku edhe nën Kurriz po ka qenë mbi Kurrizi u bojke si ma masdite, në mramje mandej zhdrypshin poshtë nën Kurriz. Kurrizi ka qenë kshtu bojshim shumë gjiro në Kurriz.

Nën Kurriz m'kujtohet kshtu kur na mbyllshin dyrtë e Kurrizit për me na bo raci. Racia ka qenë kshtu nifar' kontrolle rutinore që e bojshin kryesisht problematike për djemtë. Po për shembull në Kurriz m'kujtohet qajo ndjenja që hala e kom kaniherë, nifar' ndjenje që hala me kqyrë ku osht' dera. Mendoj që ka t'boj kshtu me qato mbyllje që na bojshin nën Kurriz. Na mshelshin te dy dyrtë. Në Kurriz janë dy dyrtë të hekurt te dy antë edhe veç kur i nijshim dyrtë e hekurit kshtu t'u i mbyllë.

Unë e kisha problem mos m'u vonu se m'dënojke babi. Ma shumë e kisha (qeshë) thojsha qitash kanë me m'vonu (qeshë) për m'u kthy n'shpi. Po domethanë qashtu Kurrizi u kanë qajo poshtnimi, poshtnimi i vazhdushëm. Për shembull ishin tre-katër polic edhe na poshtnoishin gjithë neve. M'kujtohet idhnimi jashtëzakonisht i madh që i qasaj ndjenje të poshtnimit. Ta gjujshin leternjoftimin, ia futshin djemve kah ni shpullë. Veç qajo ndjenja që tre-katër polic mujnë me na poshtnu, na ishim qashtu 100-200 nashta edhe ma shumë s'po di, po t'shpërndan nëpër kafiqa.

Po që qashtu mujnë me na mshelë edhe a din qajo heshtja edhe veç me kqyrë mos osht' dikush aty që është i kërkun politikisht, a dikush aty që mujnë me burgosë. Domethanë është qajo, qajo revolta edhe poshtnimi që e kemi përjetu kshtu në baza ditore. Mendoj që është shumë e rëndësishme m'u kujtu poshtnimi i përditshëm që kemi pasë i formave të ndryshme. Kur shoh për shembull, kur shihshim televizion kshtu filma me racizëm e kuptojshim që është i njeiti sen, është ai racizëm, ai racizëm i njerëzve që t'shohin, racizëm i qityne hapësinave.

Unë n'atë kohë jom konë ma nacionaliste se ndoshta edhe ni numër tjetër i gjenerates teme janë... për shembull ne nuk rrishim me serb. Edhe pse janë konë do vene ku në '96-ten, '97-ten për shembull u kanë nifar' radio e përbashkët mes serbëve dhe shqiptarëve, '97-ten kjo. Po për mu u kanë gjithmonë diqysh si jo se s'po na njohin subjektin tonë politik edhe dëshirën tonë politike. Kshtuqë për mu u kanë kshtu shumë problematike me komuniku.

U kanë komunikimi me serb në të '90-tat shumë problematik se m'u doke që duhet me ardhë si rezultat i ni njohje të përvojës teme edhe nuk munet me ardhë qashtu, nuk munet m'u bo sikur nuk osht' t'u ndodhë kurgjo edhe nuk mundemi mos me pru qat' politikën qaty. Kshtuqë në '97-ten kur i kemi organizu protestat e para ka qenë viti jem i parë në Fakultet Sociologji Filozofi. Ka qenë kshtu si ma n'fund, a po? Ma n'fund. Se qajo idhnimi jonë edhe mllef i a po?

M'kujtohet ai mllef, m'kujtohet që për shembull n'qat' kohë u përlejsha shumë me prindt e mi se ata e shihshin si shumë t'rrezikshme sjelljen tonë. E shihshin t'rrezikshme që na tash me qëllim po ecim

numër ma t'madh në qytet. M'kujtohet vrasja e Armend Dacit, a po? Vrasja e Armend Dacit krejt gjeneraten tem edhe për krejt njerëzit në Prishtinë ka pasë ni domethanje shumë t'madhe. Në fakt '95-ta a po? Domethanë '93-ta, '95-ta është që qikjo rezistenca pasive, rezistenca e konsolidimit të shtëpive shkolla. Nifar' gati si mësohemi, rahatohemi me qat' far' pasiviteti. S'paku në Prishtinë, s'paku në grupet e njerëzve me t'cilët unë rrisa n'atë kohë.

Domethanë lufta në Bosnje poashtu, duhet me përmend edhe këtë aspekt. Lufta në Bosnje ka qenë shumë e rëndësishme për neve në kuptimin që domethanë, na e kemi ditë që e kemi renin a po? M'kujtohet si jashtëzakonisht shumë traumatike masakra në Sarajevë, Masakra e Pazarit. Tani m'kujtohet ashtu m'shtike nana m'i fshi pluhnat edhe televizioni lshum edhe unë t'u i fshi pluhnat edhe po del masakra e Sarajevës në CNN, a çka po di çka kqyrshim qat' kohë. M'kujtohet si jashtëzakonisht shumë traumatike. Po lidhja ka qenë shumë e madhe se na e dishim që na e kemi renin.

'95-ta me Dejtonin, m'kujtohet ashtu zhgënjim jashtëzakonisht i madh. M'kujtohen ashtu pëshpëritje nëpër banesë, diskutime në mes kojshive që na harrun, metëm, çka kemi me bo tash. Se ka qenë qajo shpresa që në '95-ten me përfundimin e luftës në Bosnje edhe na hijmë në qat' diskutimin që krejt qito vjet rezistence pasive, krejt qito vjet demokraci, demokraci (ngrit dy gishta lart), i sheh dikush, a po i njeh dikush. Që qat' domethanë, zhveshje totale prej çfarëdo lloj drejtash. Është shumë e rëndësishme m'u diskutu qiky sen domethanë.

Na thjesht nuk kemi guxu me ecë n'qendër t'qytetit. M'kujtohet që i ikshim qendrës t'qytetit me shoqe se n'qendër t'qytetit ka pasë ma shumë polic. Domethanë u kanë ashtu si lojë ku me iu ikë policëve. Osh' pointi qaty. Sidomos kur ishim me shokë gjithmonë u kanë ashtu si hajde po ecim rrugicave tjera. Ka qenë domethanë... ti s'ke qenë i lirë me ecë n'rrugë n'qytetin ton, mos me folë për pasojat e ndryshme që kanë qenë n'shpi, n'gjendjen tona ekonomike, në... s'mujshim me dalë a po? Ka qenë kshtu shumicën e jetës teme adoleshente ka qenë ora policore.

Na bojshim neja midis ditës për shembull. Në ora 12:00 në mesnatë i shtrijshim perdet edhe... mandej shkojshim n'shpi me hangër drekë me prindt tanë. Qiky ka qenë realiteti. Na përherë kemi pasë ndjenjen me jetu nifar' jete normale edhe me kriju nifar' normaliteti edhe nifar' rezistence në qat' far' normaliteti. Në të njejtën kohë realiteti jonë ka qenë jashtëzakonisht denigrues edhe shtypës në secilën formë t'jetës tonë. Domethanë është shumë interesant edhe qysh adaptohet njeri me pabarazitë e qatij niveli. Ku ti për shembull çdo gja ka qenë e segregune, a po?

Ti ke qenë shumë e kujdesshme ku po shkon me ble. Ti ke qenë shumë e kujdesshme n'cilin dyqan po hin a po çka... gjithçka ka qenë e kalkulune. Për dikond që i ka 14-15 vjet gjithçka ka qenë e kalkulune edhe domethanë qato vendime që i ke bo kanë qenë vendime shumë t'rëndësishme për mirëqenien tane.

Adea Batusha: A po i bjen që... ti the që me '97-ten ke fillu fakultetin a po?

Linda Gusia: '96-ten.

Adea Batusha: '96-ten, qajo gjenerate. Kur po i bjen që... qysh u kanë masnena qajo periudhë për ty? Shkollën e mesme e ke kry n'shpi...

Linda Gusia: Shkollën e mesme e kena, e kom kry në shtëpi shkollë. Po osht' e rëndësishme ktu edhe ni sen me përmend se ka qenë shumë formative për mu personalisht, Media Projekti. Media Projekti ka qenë ni organizatë e themelune prej Aferdita Saraçini Kelmendit edhe Xheraldina Vulës. M'kujtohet e kom pasë kojshike Valentina Saraçinin, e kom pasë kojshike edhe Luljeta Pulën. E kom pasë ni hymje shumë politike, shumë interesant se sa interesant ka qenë me pasë dikond si Luljeta Pula në hymje.

Dikond që e ke pa n'baza t'ditore. Dikond që ka qenë kshtu epitoma e nifar' rezistence, epitoma e një gruaje jashtëzakonisht të artikulune, epitoma e ni gruaje që ka pasë qëndrime të artikulune politike. Domethanë ka qenë nifar' si n'qat' hymjen tonë, qat' far' mikrokosmosin e hymjes tonë e njerëzve dhe grave shumë interesante që kanë qenë aty ka qenë edhe Luljeta Pula. Luljeta Pula nuk ka marrë pjesë në çajet e orës 11:00 po...

Anita Susuri: Bash deshta me te pytë (qeshë).

Linda Gusia: Jo (qeshë). Po domethanë e gjithë hymja me nifar' mënyre kemi qenë t'angazhune. E kemi ditë kur kanë ardhë me mysafir. Për shembull kom ditë anglisht. Kom shku kaniherë me ju ndihmu qatyne mysafirëve. Luljeta ka pasë shumë mysafir ndërkombëtar që kanë ardhë. Mandej ajo u bojke si çështje e krejt hymjes m'i akomodu edhe m'i mikëprit. Ia kom harru emrin ka qenë që ka nejt ni kohë t'gjatë te Luljeta ni aktiviste e të drejtave t'njeriut. Ka qenë e verbër dhe e ka pasë ni qen.

M'kujtohet qajo dashnia unë edhe vllaznit e mi kemi pasë qef shumë kafshë. Ajo e ka pasë ni kshtu qen që ka qenë, që ju thojnë, *support dog* (qen për mbështetje emocionale). Na ia qitshim tash qenin, absesionimi jonë i mahallës me atë qen po edhe mandej kush osht' qajo gruaja e verbër? Personalitete të tilla që mandej kur i njeh edhe solidariteti ndërkombëtar edhe kur ti mbrrin m'u taku me njerëz të tjerë jashtëzakonisht t'përkushtun në çështjen e drejtësisë sociale edhe mbrrin me i pa ata kshtu si fmi në mënyrë sipërfaqësore pa e ditë rëndësinë e qityne interaksione me qisi lloj njerëz.

Qikjo shumë e rëndësishme qata njerëz që vijnë me na vizitu. Qata njerëz që i takojmë si Julie Mertus në Kosovë. Qata njerëz që janë në qat' mikrokosmosin jashtëzakonisht shumë të izolun. Me theksu që domethanë ai izolim ka qenë jashtëzakonisht i madh po ka pasë qisi dritare t'vogla t'njerëzve që na kanë vizitu po edhe, po thom, gjeneratë që kena kalu shumë kohë para televizionit. Media Projekti ka qenë nifar' organizate që ka qenë veç për vajza. Tani ka qenë organizatë feministe edhe pse jemi

shmang me përdorë emrin feministe. Kemi pasë shumë diskutime t'ashpëra të asaj që a duhet me përdorë.

Ka qenë ni hapësinë jashtëzakonisht shumë e rëndësishme për mu si vajzë në Prishtinë. Domethanë kemi fillu Media Projekt te shtëpia e Xherit jemi mbledhë zakonisht. M'kujtohet aty ka qenë Shuki Gashi. Unë Shuki Gashin e kom njoftë edhe prej tezës tem Suzanës në lidhje me ilegalen. Po domethanë, na kemi mbërri mes Media Projektit m'i taku do gra aktiviste feministe të asaj kohe që për mu kanë qenë mandej shumë formative kush jam unë, kush bohna unë.

Tash Media Projekti ka qenë qajo hapësira në dhomat edhe kuzhinat e Xherit edhe ditës ku jemi mbledhë. Për shembull, unë, Jeta Xharra, Vlora Çitaku, kush ka qenë, Ermira Çitaku ka qenë n'grupin e parë, Eli Krasniqi, Mimoza Jupa, kush ka qenë tjetër? Jehona Gjurgjala, Valentina Kraja. Ideja e grupit ka qenë me na mësu neve për gazetari. Në shkollën e mesme kom pasë qef m'u bo gazetares. Kjo ka qenë kshtu. Media Projekti ka qenë kshtu si nifar' hapësire që mes qatyne kushteve që i kemi pasë për gazetari i kemi, kemi taku edhe njerëz t'ndryshëm.

Me Media Projekt m'kujtohet për herë t'parë kemi shku në qendrën e Sevdije Krasniqit, Sevdije Ahmetit, Sevdije Ahmetit edhe Vjosa Dobrunës, Qendren për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve. Mu m'kujtohet qendra si një ndër hapësirat ma të rëndësishme edhe ma interesante t'cilat unë kom qenë. Kanë qenë ni grup i grave jashtëzakonisht të artikulune, jashtëzakonisht të fuqishme. Në podrumin e Qendres për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve e pata taku po m'doket Igon edhe Rachel. Igo edhe Rachel kanë qenë kshtu si ikona të feminizmit në Kosovë të cilat e kanë përbrendësu qata me jetu ndryshe në nifar' konteksti jashtëzakonisht patriarkal, jashtëzakonisht të dhunshëm kanë qenë qikjo qendra.

Qito hapësinat e vogla janë jashtëzakonisht të rëndësishme. Ekzistenca edhe mirëmbajtja e hapësinave t'vogla të rezistencës, pa marrë parasysh sa t'vogla janë sepse dijnë me qenë formative për jetënat të cilat i prek. Qendra e Sevdisë edhe e Vjosës kanë qenë kshtu qendra ku na kena mbledhë, kemi bo kshtu trajnime për conflict resolution. Kanë qenë qendra që mas ni kohe t'gjatë pata mrri me taku feministe t'ndryshme. Stasha, Stasha pat' qenë aty. Lepa Mladjenovic, a po? Edhe feministe të rajonit.

Për mu ka qenë shumë interesant me diskutu me njerëz të cilët kanë qenë kshtu anti Millosheviçit edhe të cilat janë mbledhë edhe kanë tentu me tregu forma të tjera të solidaritetit. Kshtuqë për mu ka qenë kjo hapësira e qendrës, qajo grupi në Media Projekt kanë qenë hapësira jashtëzakonisht të rëndësishme politikisht edhe intelektualisht.

Pjesa e Tretë

Adea Batusha: M'u ndërlihd tash pak me studimet edhe qajo periudhë. Se i bjen tash, a i bjen që e ke kry në fund të '90-tave fakultetin?

Linda Gusia: Jo se... jo nuk e kom kry fakultetin, e kom kry fakultetin ma vonë. E kom kry mas luftës. Se domethanë mas vitit t'parë në fakultet domethanë fillojnë trazirat, fillon lufta. Lufta fillon kshu në mënyrë shumë... fillon me shumë protesta në Prishtinë, fillon me masakra. Mu m'thirrë Jeta Xharra edhe m'thotë, "Lindë janë do gazetar po dojnë me shku në Prekaz, a tutesh me shku në Prekaz me ta?" "Natyrisht që s'tutna me shku në Prekaz me ta".

Qashtu shkojmë. Mezi mrrijmë në Prekaz se nuk na len policia mandej hyjmë në do far' rrugica tjera. Mundohemi me hy kah Vushtrria mandej kah Vushtrria do pjesëtar të UÇK-së të cilët nuk janë t'veshun në uniformë po të cilët jsnë UÇK na çojnë në Prekaz. Prekazi është kshu dita jem e parë kur kom punu kshu me gazetar, domethanë qajo dita meniherë sa ka ndodhë. Prekazi është kshu ndoshta prej ngjarjeve tjera kshu shumë traumatike sepse unë nuk kom... në fakt ka qenë hera e parë që unë kom pa njerëz t'vdekun.

Në fakt kur kom shku për herë t'parë në Prekaz ka qenë vetëm ni gru n'shpi ma naltë të kojshive që e kanë harru, që ka qenë e vrame. Mandej ditët e tjera në Prekaz, qikjo varrimi, rivarrimi, me hy brenda në shpi me pa Prekazin si shpi a po? Jo si qendër memoriale qysh e shohim sot. Unë sot s'kom qef me shku në Prekaz se për mu nuk ngjason aspak, domethanë e ka rrafshu komplet qat' faktin që Prekazi ka qenë shpi dikujt edhe që njerëzit janë konë t'u pi çaj, t'u hangër buk. Që kanë rezistu po, po kanë rezistu n'shpi t'vet.

Është shumë e rëndësishme që unë jom gjithmonë kshu, në secilin rast thom që është shumë e rëndësishme mos me deformu deri n'qat' masë historinë në kuptimin që me dehomanizu. Sepse unë çka maj mend prej Prekazit, emrave, të gjithë atyne njerëzve që kanë vdekë edhe gjithë atyne fmive mbaj mend qato gjygyrat me ngjyra, mbaj mend qato kpucat t'llastikut, qizmet e llastikut të shpërndane. Mbaj mend sahanat e metalta me përsesh a po?

Mbaj mend qisi detaje edhe plumba, domethanë, kurrë n'jetë ti s'mujsh me ecë prej plumave edhe prej dhunës t'madhe që është bo në shpi. Menoj që është shumë me rëndësi me i kap qato detale. Qajo ka qenë dita jem e parë kur kom punu me gazetar dhe manej s'jom nalë asniherë. Kom punu kryesisht me Washington Post. Kom punu edhe me gazetar tjerë po kryesisht kom punu me Washington Post-in për krejt vjetët gjatë luftës. Kshuqë gjatë krejt qasaj kohe kom qenë vazhdimisht në teren.

Kom qenë kshu shumë afër t'u përcjellë krejt ngjarjet e '98-tes, '99-tes, 2000-tes në Kosovë. Kshuqë mas luftës ka qenë shumë vështirë m'u kthy në fakultet. Sepse u kanë diqysh a ka... çka me bo tash kur u kry lufta a po? Nait Vrenezi ka qenë profesori jem i psikologjisë sociale, profesor i jashtëzakonshëm. E ktu është qajo rëndësia e individëve edhe njerëzve që ashtu... me profesorin Nait Vrenezi, po... '96-ten domethanë qysh i njoh unë Naitin e krejt kta njerëz i njoh... me Naitin e kom pasë mentor.

Soros jepke '97-ten studentëve t'mirë bursa për, u qujtë Invisible University. Kto kanë qenë domethanë si kurse shitesë. Me profesorin diskutojshim. Qishtë domethonë ka qenë. M'jepke profesori libra, shkrujsha, reflektojsha. Domethanë ka qenë si kurse shitesë që i kemi majtë. E mas luftës m'kujtohet ashtu e kisha shumë t'vështirë me u kthi në fakultet. E profesori ka qenë kshtu si shumë insistues që me ju kthi studimeve edhe me vazhdu.

Une mandej qashtu... niherë mas luftës... domethanë vazhdoj me punu me gazetar po edhe rikthehna në studime, deri në 2001-ten. Mandej 2001-ten pranohna në NYU në master. Për mu bohet shumë e rëndësishme me lëvizë prej Prishtinës, me dalë prej Prishtinës. E shoh si domethanë, shumë sene mas luftës nuk më pëlqejnë. Kom pasë nifar' ideje të nifar' superioriteti moral edhe etik të... mandej senet që ndodhin mas luftës në Prishtinë shpërfaqin kshtu, shpërfaqin njerëzoren, shpërfaqin lakminë, shpërfaqin mungesën e idealeve, shpërfaqin dashakeqësinë, shpërfaqin urrejtjen ndaj tjerëve.

Kshtuqë, domethanë, qajo periudha e mas luftës është periudhë shumë e vështirë në kuptimin ideologjik edhe në kuptimin e gjetjes së njëfar' kuptimi a po? Se deri '90-tat pa marrë parasysh sa të vështira janë në të '90-tat jemi shumë të mobilizun se kemi nifar' sensi shumë t'madh të përkushtimit ndaj, domethanë, qisaj që jemi t'u e bo. Domethanë për neve osht' akt rezistence me shku n'shköllë, osht' akt rezistence me qenë nxans i mirë, osht' akt rezistence me marrë me lexu krejt çka munësh me lexu.

Sepse osht' diqysh si, ti je t'u reagu kundër qasaj shtypjes edhe kundër... qajo ideja që ty po dojnë me t'lanë mrapa e emancipimi vjen me shkollim. Emancipimi vjen me angazhim. Na në të '90-tat e kemi pasë shumë t'qartë ku jemi, çka jemi. Gjatë krejt kohës kur kom qenë me gazetar ndërkombëtar e kom pasë qit' far' sensi që jom në nifar' mënyre t'u negociu dhe jom në nifar' detyre poashtu. E kom nifar' si nifar' obligimi poashtu me tregu qito rrëfime që po ndodhin në Kosovë se unë po i di dy fjalë anglisht edhe për mu osht' shumë e rëndësishme me tregu historinë e Kosovës edhe me tregu çka po ndodhë në Kosovë.

Për mu e plot tjerë të gjeneratës teme që punojnë si përkthyes n'qat' kohë përkthimi është si nifar' negociimi i qatyne dy botnave. Përkthimi është nifar' mënyre e tregimit, e gjetjes së zërit, e narracionit për rrëfimet tona, për historitë tona. Kshtuqë është nifar' akti i jashtëzakonshëm i ndjenjës së detyrës. Është nifar' akti jo vetëm i rezistencës po nifar' akti i detyrës dhe nifar' ndjenje që ti je t'u ndihmu me jep zo historive që përndryshe kishin me qenë të shtypuna.

Për qata për mu ka qenë shumë e rëndësishme me mrri me shku gjithkah, me mrri me folë me shumë njerëz, me mrri me përkthi edhe me insistu me shku n'do vene. Për shembull shumë shpesh kanë thanë, "Jo, shumë rrezik. S'po shkojmë". Për mu ka qenë, për shembull ni ditë m'kujtohet kom punu me CNN sepse me CNN ka qenë rroga ma e madhe po ka qenë puna ma e poshtër se m'kujtohet ton

ditën kemi nejt në Grand Hotel. Për mu ka qenë kshtu, okej a jena t'u shku n'teren a jo. Ata kanë thanë, "Jo se ka shumë luftime", "Okej, ditën e mirë. Unë nuk muj me punu".

Domethanë ma përpara shkoj me dikond që, kondo që shkon n'teren edhe shkoj në teren sesa me nejt ton ditën në Grand edhe me perkthi tituj t'gazetave. Kshtuqë për mu ka qenë domethanë shumë e rëndësishme... për mu edhe krejt neve tjerve që kemi punu n'teren n'atë kohë ka qenë shumë e rëndësishme qajo. Tereni ka qenë ma i lehtë për neve çikave. Për neve ka qenë diqysh pak ma lehtë me i negociu check pointet se nuk na merrke kërkush seriozisht. Se ju dukshim, a din, si... e para kemi qenë shumë t'reja, une, Tina, Jeta Xharra, Belma. Kena qenë ni grup që kemi qenë vazhdimisht n'teren.

M'kujtohet që u kanë kshtu ni emërues i përbashkët që ne depertojshim lehtë se neve kërkush s'na merrke shumë seriozisht. M'kujtohet që shumë shpesh kemi mrri me hy, "Hajt bre se veç deri qaty po du me shku se osht' nifar'... po dojnë veç me folë me qita njerëz". Shumë shpesh hyshim qishtu t'u mos na marrë seriozisht se ju dokshin që s'jena t'u kuptu ku jena as çka jena as çka jena t'u bo. Kshtuqë kaniherë osht' qajo lehtësia kur je e padukshme si gru edhe kur s'të marrin seriozisht. Ka edhe ni benificion nëse din me shfrytëzu. Kshtuqë po, qajo.

Mandej mas luftës unë kthehna në fakultet i përfundoj studimet edhe gjatë luftës unë kom qenë n'kontakt me njerëz t'ndryshëm, gjatë bombardimeve. Kom pasë rastin me taku Tony Judt. Tony Judt ka qenë profesor në NYU. Me Tony-n patëm diskutu shumë gjatë për përvojat e mija si përkthyes po e diskutojshim për shembull qat' banalitetin e së keqës. Mu m'kujtohet qat' kohë e pata lexu Hannah Arendt edhe atij i pat' lanë shumë përshtypje interpretimi jem kur për shembull mu m'ka ra shumë shpesh me nejt gjatë në check point derisa... na lejshin qishtu kah 20 minuta gjysë ore.

Ti e dishe që tash kta t'njejt njerëz kanë vra njerëz para 15 minutave edhe po sillen shumë okej, po dojnë me ta jep ni copë bostan. Qajo diskrepanca edhe qajo, po edhe ai niveli i dehumanizimit të tjetrit, a din. Domethanë unë kom folë mirë serbisht. Apriori e kishin si nifar', "A okej ti po din me folë serbisht, a je tamon shqiptare?" Po qajo domethanë, qato nivelet e dehumanizimit. Me Tony Jod patëm mbetë në kontakt.

Mandej kur i kom kry studimet ktu, hala pa i kry studimet ktu e kom pasë qat' nevojën e madhe me dalë prej Kosovës. E kom pasë qat' nevojën e madhe me u largu fizikisht prej Kosovës, u kanë kshtu shumë e madhe qajo nevojë me ikë. Po shumë e madhe u kanë nevoja poashtu m'i jep kuptim krejt çka, krejt çka kom pa edhe çka kom përjetu edhe çka ka ndodhë në Kosovë. Për mu domethanë me vazhdu me lexu, me vazhdu me ndërlihd me histori tjera ka qenë nifar' forme e terapisë edhe nifar' forme e artikulimit.

Profesori Vrenezi ma pat' bo, "Kaniherë kur nuk je gati për kujtime i shtin kujtimet në fijoka edhe vazhdon jetën edhe mandej kur je gati edhe kur i ki mjetet për m'i çelë fijokat, i hapë fijokat". Për mu

qato fjalte e profesorit kanë qenë shumë t'rëndësishme për mu se kanë qenë okej unë veç i kom kap i kom shti krejt kujtimet e luftës nëpër fijoka se kanë qenë shumë, shumë t'papërpunueshme edhe kom ikë për New York.

Kom apliku në shumë shkolla po kur i kom shkru Tony Judt që jom pranë në NYU Tony ma ka ofru ni bursë të Remarque Institute edhe mandej kur kom shku në NYU ka qenë kshtu nifar' përvoje e jashtëzakonshme edhe ni përvojë e rritjes intelektuale. Se kom pasë fatin aty në Remarque Institute ka qenë Richard Sennett. Ndër sociologët shumë ma të famshëm edhe m'kujtohet që krejt klastë e Richard Sennett u patën mbyllë. Po Tony i pat' thanë, "Linda ka ardhë prej Kosovës, njoftohu". Edhe patëm fillu me folë edhe ma pat' bo ai, "Pse s'je ti n'klasën tem?" Pata shku te Richard Sennett.

Për mu ka qenë shumë e rëndësishme mandej me zhvillu qit' idenë e rëndësisë së klasës shoqërore, idenë e përkatësisë. Duhna me thanë që kur kom shku në New York ka qenë kshtu si dy javë para 9/11. Kshtuqë ka qenë krejt diskutimi (qeshë), ka qenë... merrsha email-a prej Prishtinës, 'Ka t'shton ti, diçka ka me ndodhë'. Po ka qenë shumë interesant me krejt përvojën e Kosovës edhe me krejt qat' ndjenjë me ikë prej luftës me shku në ni realitet t'ri tash në Amerikë të 9/11.

Për mu 11 shtatori ka qenë ashtu wow. Qajo ndjenja e patriotizmit, qajo ndjenja e flamujve, qajo ndjenja e diskutimeve n'klasë po edhe darkave që na ftojke Tony Jod me njerëz të ndryshëm edhe diskutimi edhe artikulimi i qatyne përvojave po edhe... diqysh për mu ishte shumë e rëndësishme tashti me nifar' niveli global edhe me ngjarje globale me i jep kuptim ngjarjeve që i kisha dëshmu edhe ngjarjeve t'jetës teme. Kshtuqë ka qenë kshtu si, qato dy vjet në NYU kanë qenë jashtëzakonisht t'rëndësishme me pasë krejt... mandej t'profesorët edhe qato diskutimet e gjata për nacionalizmin edhe kombin...

Po, po po unë e di qysh osht' kur kom shku si refugjat në Shqipëri edhe pata shku me Washington Post se mandej unë pata vazhdu me punu meniherë. Kur ma kanë bo, "Adresen e shpisë", edhe unë s'kom ditë ku me qit' adresen e shpisë. Kur ma kanë bo, "Shteti?" Edhe e diskutojshim qat'... domethonë, po qajo, dosmopolitanizmi, qajo ideja e post shtetit po t'njejtën kohë nëse secili, nëse gjithkrah ti je qytetare e ni shtetit atëherë qysh mujmë me tejkalu. Kshtuqë kanë qenë diskutime t'rëndësishme intelektuale për mu qato të New York-ut.

Adea Batusha: Edhe pak për iniciativën tonë edhe shtëpitë shkolla, qato që i ke dokumentu?

Linda Gusia: Po. Mandej kur jom kthy prej New York-ut m'patën ftu meniherë kshtu si asistente edhe kom qenë ktu n'fakultet. Mas shumë vjetve diçka si, mas ni kohe kom qenë kshtu si, e kom pasë sociologjinë urbane si landë. M'kujtohet e lexojshim Michel De Certeau edhe qajo subjektivitetin edhe unë thojsha, "Secili e kena qytetin tonë, secili i kena hartat tona". Edhe shumë rastësisht po e përmendi shtëpinë shkolla n'klasë.

Domethanë për shembull osht' format mbi Kurrizi, Kurrizi, Shtëpia e Herticëve. Diqysh osht' si harta jeme mendore e Prishtinës, a po? Elita do qisi sene t'vogla është qysh unë e paramendoj Prishtinën, Prishtinën e rinisë teme. Studentat, "Shtëpitë? Çka je t'u folë?" "Kush e ka kry në Sami Frashër?" Në sociologji gjithmonë ka dikush që e ka kry në Sami Frashër. P'e çojnë katër pesë veta dorën. "Qysh? A e dini për vitet e '90-ta edhe kërkush domethanë, krejt e kishin shumë të mjegullt këtë idenë e shtëpitë shkolla.

M'kujtohet kur unë e pata bo kshtu si mision edhe m'kujtohet kur për herë t'parë veç i pata marrë kshtu studentat edhe kom thanë, "Qysh nuk i dini shtëpitë? Okej. Hajde". Po hypim në autobus prej klasës edhe jemi nisë jemi hyp në tresh n'atë kohë edhe jemi shku naltë. Edhe për mu ka qenë hera e parë mas luftës. M'kujtohet kur jom shku e kom pa, 2012-ta qashtu diçka, 2012-2013. Kur e kom pa shpinë, ka qenë shumë shokante se unë s'e kom pa shpinë e djegun. N'kry tem shpija ka qenë shumë ma e madhe edhe për mu ka qenë kshtu hera e parë kur kom hy me studenta edhe ka qenë qashtu llog, t'përlyt a din rrëmujë.

Okej, qitu unë e kom kry shkollën edhe e di që pata pasë kshtu nifar' shtytësi m'i thirrë krejt njerëzit edhe me folë me krejt njerëzit të gjeneratës tonë. Kom thanë, "A e dini qysh osht' shpija? A ke qenë ndonjëherë?" Qashtu ka fillu në mënyrë shumë spontane nifar' diskutimi i krejt neve për shtëpi shkolla. Patëm dashtë me bo nifar' iniciative që familjarët s'kanë qenë kshtu shumë të entuziasmun. Me shku me pastru kemi thanë, "Jo shkojmë e pastrojmë na". Diqysh ka qenë për mu shumë e rëndësishme sepse ka qenë e rëndësishme me shku m'i diskutu të '90-tat.

Ka qenë e rëndësishme m'i diskutu të '90-tat sepse për mu qajo nevoja për me kultivu komunitete, nevoja për me diskutu rëndësinë e solidariteteve ka qenë shumë e rëndësishme. Për mu dokumentimi i t'kalunës ka pasë ma shumë t'boj me t'ardhmen sesa me nifar' nevojë për romantizimin me t'kalumën. Unë nuk kom kujtesë qaq t'mirë, i harroj senet, i harroj datat, i harroj emrat. Po si... për mu ka qenë shumë e rëndësishme që historia e Kosovës nuk është vetëm '98-ta, '99-ta. E kupoj që '98-ta, '99-ta eklipsojnë komplet çka ndodhë në '90-tave po historia jonë fillon shumë ma herët, a po?

Me katra gjyshra tanë e krejt ato po po du me thanë e jona, e jemja personalisht. Domethanë e ka ni kahje komplet tjetër në '89-ten. Shtëpitë shkolla janë shumë të rëndësishme edhe rezistenca paqësore është shumë e rëndësishme. M'kujtohet kur kom qenë në fakultet në NYU pata lexu se temën e pata marrë për... Richard Sennett ma bojke, "S'je e gatshme me shkru kurgjo tash për luftën. Duhesh me lanë distancë. Merr diçka...". Unë ia bojsha, "Po krejt qëllimi për me shkru për, me studiu për mu osht' m'i jep kuptim përvojave t'mija edhe unë po du... arsyeja pse unë po vi n'shköllë edhe me vazhdu studimin është m'i pasë qato mjete, me qenë unë narratore historisë teme", "Atëherë masi po institon gjeje ni moment që nuk osht' qaq traumatik".

Për mu momenti që s'u kanë qaq traumatik u kanë momenti i viteve t['90-tave. Edhe pse u kanë traumatike po domethanë u kanë politike po s'u kanë aq traumatike sa '98-ta dhe '99-ta. Kshtuqë kur

filloj me shkru kshtu në mënyrë spontane. Se unë mendoj që qato vjet mas luftës... shumë shpesh e foli edhe me shogen tem t'mirë Antoneta Kastrati, me Elin, me Nitën. Domethanë neve na ka vy goxha do kohë si gjeneratë, do vjet ku pernime e patëm shti në fijoka ngjarjet e luftës sepse e kishim shumë t'rana m'u ballafaqu. Na ishim qajo gjeneratë që u nijshim që s'kemi jetu boll.

Tashti kishim nevojë me, me jetu po kur e kom kuptu që... se e hupa fillin e mendimit. Çka deshta me thanë osht' që një prej seneve që pata lexu gjatë pregaditjes së tezës së megjistraturës ka qenë që shoqëritë që kanë kultivu rezistencë paqësore dhe kanë një masë kritike, ni shoqëri civile të fortë kanë demokraci ma t'forta dhe kanë tranzicione ma t'mira dhe kanë shansa ma t'mira m'u bo shtete apo vende ma demokratike edhe ma t'jetushme sesa vendet që shkojnë drejt në luftë.

Për mu mandej kshtu si gërrmimi në të '90-tat ka qenë si kthimi te, për mu ka qenë shumë e rëndësishme me e analizu, me diskutu, me pru n'pah edhe n'sipërfaqe solidaritetin. Me pru në pah që ni rezistencë paqësore, shtëpitë shkolla në mënyrë t'veçantë kanë qenë kshtu si ndërmarrje e të gjithëve. Neve që kemi shku si nxanës aty, prindërve tanë që kanë kontribu n'forma t'ndryshme, njerëzit që i kanë liru shtëpitë, profesorëve tanë që kanë pasë zellin edhe idealin që mësimi edhe arsimi osht' jashtëzakonisht i rëndësishëm. I qatyne elitave politike që vazhdojnë me mirëmbajtë qata.

Për mu ka qenë shumë e rëndësishme edhe shumë shokante mas luftës kur e kom kuptu prej studentave t'mi që në fakt krejt të '90-tave janë shumë të turbullta edhe nuk ka shumë kujtesë për të '90-tat. Për mu mandej m'u pat' bo kshtu si pelegrinazh shkojshim çdo vit me çdo gjeneratë. Krejt në sociologji urbane e kanë ditë... "A din dikush diçka për shtëpitë shkolla?" "Kena ni diçka", "Çka dini?" "Hajde në autobus". Në tresh edhe shkojshim e bojshim si ngjarje kshtu ton ditore.

M'kujtohet kur ka kandidu Shpend Ahmeti si dikush që e kom njoftë, dikush i gjeneratës teme. U pata entuziasmu shumë edhe ia pata bo Shpendit, "Hajde po shkojmë". Patëm shku patëm diskutu. Shpendi pat' premtu që ka me shndërru Shtëpinë e Herticëve në muze. Pat' fillu me do iniciativa dhe për mu ka qenë mandej shumë interesant me mendu qat' metamorfozën me thanë e qasaj shtëpie që ka qenë shkollë edhe që tash po don m'u bo muze.

2018-ten ka qenë nifar' mundësie me... ni grand t'madh ndërkombëtar me apliku edhe unë kom mendu, okej, osht' shumë e rëndësishme me diskutu, me mendu po edhe me qenë pjesë e ndërtimit të qisaj, të muzeut. Domethanë, çka ka qenë? 2017-ta kur Shpendi e pat' shpallë, a p'e sheh? Unë edhe datat. Ai ka qenë viti ku Shtëpia e Herticëve është shpallë muze teknikisht. Hala s'osht' muze po ai ka qenë viti. Për mu ka qenë mandej shumë e rëndësishme me kontribu në mënyrë a tjetër.

Unë mandej si dikush që n'rend t'parë e shoh vetën si pedagoge m'u ka shumë e rëndësishme edhe e vetmja mënyrë që kom mujtë me bo... se krejt rikthimi te historia ka qenë mes nxanësve t'mi. Për mu diskutimi për t'kalunën është gjithmonë osht' qysh ju tregojmë tash gjeneratave t'reja edhe çka ju tregojmë. Për mu ka qenë okej hajde ta bojmë... e kom shkru ni projekt ku projekti ka fitu, ka qenë

kshtu projekt ndërkombëtar. Unë i kom fitu do pare për me fillu diskutimin edhe në nifar' mënyre digjitalizimin e do prej dokumentacioneve për shtëpitë shkolla.

Kemi fillu me student. Jeta Rexha m'ka ndihmu jashtëzakonisht shumë gjatë procesit. Po kemi fillu me studentët e sociologjisë edhe çka kemi bo osht' kemi fillu me bo intervista me njerëz të ndryshëm. Për mu ka qenë shumë e rëndësishme që historia e shtëpive shkolla edhe historia në përgjithësi mos me qenë kshtu singulare, mos me qenë një za, mos me qenë një rrëfim. Për mu ka qenë shumë e rëndësishme mos me qenë vetëm organizatorët, mos me qenë vetëm njerëz kryesor t'shkollave që kanë organizu po me qenë nifar' diskutimi i përvojave shumë të ndryshme të shkollës.

Për mu ka qenë shumë e habitshme gjatë procesit me pa që në fakt për herë t'parë procesi fillon ma herët në mënyrë spontane. Kemi folë me Zijadin Gashin. Zijadin Gashi po edhe me mësueset tjera që kemi folë thojnë, 'Na kemi fillu qishtu nëpër shpija'. Për mu ka qenë shumë interesante se sa krejt ky proces i cili është shumë i rëndësishëm për t'gjithë për shembull ka fillu prej msuseve të Elena Gjikës kryesisht. Mësuesve të shkollës nëpër Prishtinë që në mënyrë shumë spontane kanë fillu me shku nëpër shpija të nxanësve, nëpër dhoma t'ditës apo m'i thirrë nxanësit në shpija t'veta dhe domethanë me nifar' mënyre si spontane me vazhdu mësimin.

Për mu për shembull kjo ka qenë ni prej zbulimeve ma t'rëndësishme të qitij hulumtimi për shtëpi shkolla. Ideja e hulumtimit ka qenë veç me mbledhë sa ma shumë dokumentacione, m'i digjitalizu. Për mu atëherë ka qenë nifar' bindje që nëse i digjitalizojmë atëherë i përjetësojmë në nifar' mënyre po edhe qajo qasja e të gjithëve. Po për mu ka qenë edhe vazhdon me qenë qajo ideja e shtëpisë shkollë muze. Mënyra si osht' ndërtu, koncepti i tij themeltar ka t'boj me shumë njerëz. Është kështu ndërmarrje kolektive dhe si e tillë qashtu duhet m'u kriju, qashtu duhet m'u mbajtë mend.

Krejt zërat e ndryshëm, përvojat e ndryshme që kanë kontribu n'forma t'ndryshme duhet m'u dokumentu. Tentimi ka qenë ma shumë me hap diskutim rreth qitij multiciteti t'narracioneve, nevojës për m'i shiqu gjërat ndryshe të nevojës për me kap të përditshmen. Rëndësisë për me kap qat' jetën e përditshme edhe rëndësisë së dokumentimit të saj. Për mu ka qenë shumë e rëndësishme që muzeu i ardhshëm në nifar' mënyre me mishnu idenë themeltare të qityne shkollave që kanë qenë domethanë e para rëndësia e shkollimit, e dyta kolektiviteti edhe komuniteti si formë jashtëzakonisht e rëndësishme e çfarëdo lloj mbijetese.

Në periudhën kur kemi fillu me punu ma shumë edhe me diskutu m'kujtohet kur kemi diskutu me student që kanë qenë pjesëtar të shpive shkolla, pjesëtar të këtij projekti. Në diçka që m'ka lanë shumë përshtypje ka qenë, Toska m'kujtohet ka thanë, "Po mirë, na tash jemi t'u jetu kshtu në zhdukjen e madhe të gjashtë. Jemi t'u jetu në kohë të krizës së madhe mjedisore ku jeta jonë për dhjetë vjet e ardhshme ka me ndryshu në mënyrë radikale. Pse osht' e kalunja e rëndësishme?" Për mu ka qenë shumë pyetje e rëndësishme me diskutu edhe me mendu sahere që marr çfarëdo lloj ndërmarrje me diskutu t'kalunen.

Është shumë e rëndësishme për mu gjithmonë në qit' prizëm me shiqu. Çka dojmë me ju tregu njerëzve tjerë për t'kalunen. Dojmë me ju tregu shembuj t'ndryshëm të rezistencës, dojmë m'ju tregu rëndësinë e madhe t'komunitetit, dojmë m'ju tregu rëndësinë jashtëzakonisht t'madhe të komunitetit në mbijetesë në kohërat ma të errëta. Kshtuqë është shumë e rëndësishme me i lanë ni shembull edhe ni dokumentim të rezistencës e cila osht' shumë organike, qysh m'u ka dokë mu, po osht' e shumëfisht edhe involvon njerëz të ndryshëm.

Unë kshtu kom pak problem me qit' narracionin e herove edhe kush janë njerëzit edhe burrat edhe gratë që kanë nisë krejt kta. Mendoj që është shumë e rëndësishme m'i njoftë edhe m'i vlerësu njerëzit të cilët kanë nisë edhe kanë pri procese t'tilla. Po shumë e rëndësishme poashtu për sot me theksu, e para rëndësinë sado t'vogël a po? Sado t'kqija janë hapësirat, sado t'parëndësishme si podrumi i Sevdijes edhe i Vjosës a po? Ka qenë podrum në ni shtëpi private a po? Te vorret e Rugovës sot. Ka qenë podrum që ka kriju artikulum politik.

Ka kriju pastaj, e ka mbjellë qat' faren e një mendimi feminist, ni mendimi edhe rezistence tjetër që merr mandej trajta edhe forma tjera në 2000-tat në Kosovë e tutje. Po kshtu për mu shtëpitë shkolla kanë qenë si kshtu, si nifar' forme e krijimit të qasaj kujtesës për rëndësinë e komunitetit edhe rëndësinë e solidaritetit në kohë të errëta. Mendoj që qajo është leksioni ma i rëndësishëm edhe që muj me tregu me historinë e shtëpisë shkolla po mendoj historinë e krejt të '90-tave edhe historinë e krejt 2000-tave.

Shumë e rëndësishme për mu me theksu vazhdimisht... për mu ka qenë shumë e rëndësishme me theksu se cilat janë qato elementet që i bijnë pushtetarët autoritar në pushtet si Millosheviçi. Çka mujnë me bo, a po? Shikimi në histori është gjithmonë për të ardhmen dhe të tashmen, shumë pak është për t'kalunën pernime.

Domethanë për mu nuk është e rëndësishme datat, dokumentimi, arkivimi. Ajo shumë e rëndësishme për institucionet po shumë e rëndësishme për mu ka qenë në këtë projekt që studentat me pasë nifar' ndjenje të... që kur dokumentojmë, kur kujtojmë momente t'kalune të historive t'caktune me i shiqu storiet e shumëfishta dhe me i shiqu krejt qato nyjet e ndryshme që na shërbejnë për të tashmen edhe të ardhmen.

Anita Susuri: Faleminderit shumë! Nëse keni edhe diçka për fund me shtu nëse jo...

Linda Gusia: Shumë kom fol (qeshë). Nuk e di domethanë për mu ke... për mu është e rëndësishme pernime është jashtëzakonisht e rëndësishme theksimi i faktit që hapësirat dhe krijimi i grupeve të ndryshme të njerëzve t'cilët e përkrahin njani tjetrin e t'cilët krijojnë hapësira të ,mendimeve kritike e diskutimeve osht' thelbësor për një shoqëri edhe një komunitet. Mendoj që nëse dojmë m'i kqyrë me

çfarëdo lloj romanticizmi të '90-tave është qajo, qiky segment i solidaritetit dhe komunitetit të cilin unë e kisha veçu.